



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	05.02.2025	11.02.2025	2025/0089

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.02.2025, OE "GMM Group" SH.P.K.- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0089, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "LEICON" SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "SHËRBIMET PËR PASTRIMIN E AUTOMJETEVE POLICORE PËR REGJIONIN E PRISHTINËS", me nr. të prokurimit: "214-24-13221-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: sherbim, vlera e parashikuar e kontrates: 124,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/0089 i dt:03.02.2025. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Autoriteti Kontraktues: POLICIA E KOSOVES

Shkeljet e dispozitave të LPP janë si me poshtë :

Neni 1 - Qëllimi I LPP-se

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me rastin e mos rekomandimi të kompanisë tonë për dhenje të kontratës Autoriteti

Kontraktues POLICIA E KOSOVES ka bërë këto shkelje:

1. Shkeljet e dispozitave të LPP:

Me datën 23.01.2025 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin tuaj, ku keni rekomanduar për kontratë LECION SH.P.K i cili nuk i plotson kriteret e kërkuara të përcaktuar nga ana juaj në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë:

Neni 1 - Qëllimi i LPP-se

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 6 pasi ka rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, që do të thotë nuk është sipas dispozitave të LPP-se.

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Autoriteti Kontraktues duke na diskriminuar ne si Operator Ekonomik të përgjegjshëm dhe kanë zgjedhur ta shpërblejnë për kontratë një Operator që nuk i plotson kriteret e kërkuara në Dosje të Tenderit dhe në Njoftim për kontratë.

Autoriteti Kontraktues POLICIA E KOSOVES nuk ka respektuar dispozitatë të LPP-se duke rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik LECION SH.P.K duke pasqyruar se ky OE nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara pasi që adresa e autolarjes e kërkuar në dosje të tenderit përcakton se autolarja duhet të jetë në Podujevë, ndërsa OE LECION SHPK ka dorëzuar një

lokacion per pastrim te automjeteve ne nje fshat larg Podujeves, me distance 4.2km larg nga stacioni policor ne Podujeve, andaj me kete lokacion krijohen shpenzime te automjeteve per pastrim te veturave dhe mund te shkaktoj vonesa te ndryshme gjate orarit te punes, pasi qe kerkesa e AK-se eshte qe t'i kete prioritet kryesor automjetet per pastrim, andaj duke pasur parasysh se ne dosje te tenderit eshte kerkuar tre(3) lokacione brenda komunes se Prishtines per te mos pasur keto lloj shpenzime pasi qe autolarja me lokacion ne Vranjevc eshte vetem 2km nga qendra dhe prap eshte kerkuar qe te kete vendpunishte ne kete lokacion poashtu edhe ne lokacionin e Emshirit.

Autolarja e cila eshte dorezuar me baze ne qender te Prishtines mendojme qe nuk i ploteson kriteret per vendpunishte pasi qe nuk ka parking te mjaftueshem per automjete te PK-se, duke ditur kerkesen e shumte per pastrim te tyre. Prandaj, mendojme qe nuk eshte i pershtatshem pasi qe nuk ka vend parkime te mjaftueshme per hapesirat qe zene keto vetura. OE nuk ka leshuar deklarate te vulosur dhe nenshkruar per piken ne Mutivode se ku do te pastrohen automjetet e ketij kufiri. Autoriteti kontraktues nuk ka kerkuar qe te beje verifikimin e largesise nga stacionet policore dhe vendpunishteve.

Duke pasur parasysh natyren e automjeteve te PK-se dhe mjetet e punes qe bartin ne veturat e tyre duke perfshire armet, fisheket, rrobat, letrat konfidenciale, supozojme(mendojme) se autoriteti kontraktues ka bere shkelje te rende pasi qe ka pranuar nje kontrate e cila gjendet me lokacion ne Emshir dhe sipas burimeve qe i posedojme ky kontraktor ka vepra penale per te cilat akuzohet dhe eshte i denuar andaj si eshte e mundur qe te pranohet nje kontrate e tille duke rrezikuar sigurine automjeteve te policise dhe vete ata? Kontrata e nenshkruar dhe dorezuar nga LECION SHPK me nr. unik identifikues: 812053958 lidh kontrate me kete person: VELI GASHI me nr personal: 1250895638 i cili supozohet(mendohet) qe posedon vepra penale gje qe eshte ne kundërshtim me ligjin.Andaj, kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit te merret me rastin ne fjale pasi qe eshte nje kontrate e kunderligjshme nje suate e tille.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmitet dhe faktet te cilat u ceken me larte, kerkojme nga ju si Autoritet Kontraktues qe te nxejrrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kerkesa per rishyrtim e GMM GROUP SH.P.K.

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se per dhenie te kontrates dhe lenda te kthehet ne ri-vlersim dhe gjate ri-vlersimit, ekzaminimit, vlersimit dhe krahasimit ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, njoftimit per kontrat dhe konform dispozitave te LPP-se.

Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojm proceduren ligjore ne institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:

- a) Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë neni 65 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin. No. 05 L-092, do të dorëzohen në formë të Aneksit 2.
- b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.
- c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë” së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.
- d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- a) Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
- b) Vërtetim nga Administrata Tatimore.
- c) Vërtetim nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar.
- d) Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje e noterizuar.

Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që do të thotë se ofertuesi do të refuzohet, do të humbasë garancinë e sigurisë së ofertës dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1 Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik-Çertifikata e Regjistrimit Numri Unik Identifikues (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës).

Kërkesa 2 Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi 1 Çertifikata e Regjistrimit Numri Unik Identifikues e leshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (kopje).

Dëshmi 2 Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor).

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 Operatori ekonomik është i obliguar që të ketë autolarje në secilën komunë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues të përshkruara në dosje të tenderit në specifikat teknike. Aneksi 1 (OE nëse nuk ka autolarje të vetën është i obliguar të ofrojë dëshmi mbi marrjen me qera apo marrëveshje për shfrytëzim për ofrimin e shërbimeve të kërkuara) marrëveshjet duhet të jenë të noterizuara dhe në afat kohor prej 36 muajve.

Kërkesa 2 Deklarata për specifika teknike mbi përmbushjen e specifikave teknike sipas Aneksit 1.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi 1 OE duhet të ofrojë dëshmi me shkrim se ku mund të bëhet pastrimi i automjeteve nëpër komuna – për Regjionin. Nëse OE nuk ka objekt të vetin nëpër komuna atëherë duhet të ofrojë kontratë ose marrëveshje në mes të OE dhe pronarit të autolarjes ku do të bëhet pastrimi për secilën Pjesë marrëveshjet duhet të jenë të noterizuara dhe në afat kohor prej 36 muajve.

Dëshmi 2 Deklarata për specifika teknike mbi përmbushjen e specifikave teknike sipas Aneksit 1.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË:

Komisioni i vlersimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këto aktivitete të prokurimit, konstaton se për këto projekt janë pranuar dy (2) oferta, komisioni vlerësues rekomandon si në vijim: të jepet kompanisë "Leicon", sepse i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit si dhe është oferte e përgjegjshme me çmim më të ulët.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - GMM Group SH.P.K.

Operatori Ekonomik ankues në ankesë e kundërshton ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës në procedurën e prokurimit: “SHËRBIMET PËR PASTRIMIN E AUTOMJETEVE POLICORE PËR REGJIONIN E PRISHTINËS”, me nr. të prok: 214-24-13221-2-2-1, dhe pretendon se OE i rekomanduar nuk ka prezantuar marrëveshjet mbi marrjen me qara, sipas kritereve të vendosura nga AK, në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK – Policia e Kosovës, për këtë procedurë të prokurimit në kërkesën nr. 3 tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional është kërkuar:

“Kërkesa 1: Operatori ekonomik është i obliguar që të ketë autolarje në secilën komunë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues të përshkruara në dosje të tenderit në specifikat teknike Aneksi 1 (OE nëse nuk ka autolarje të vetën është i obliguar të ofrojë dëshmi mbi marrjen me qera apo marrëveshje për shfrytëzim për ofrimin e shërbimeve të kërkuara) marrëveshjet duhet të jenë të noterizuara dhe në afat kohor prej 36 muajve.

Dëshmi 1: OE duhet të ofrojë dëshmi me shkrim se ku mund të bëhet pastrimi i automjeteve nëpër komuna – për Regjionin. Nëse OE nuk ka objekt të vetin nëpër komuna atëherë duhet të ofrojë kontratë ose marrëveshje në mes të OE dhe pronarit të autolarjes ku do të bëhet pastrimi për secilën Pjesë marrëveshjet duhet të jenë të noterizuara dhe në afat kohor prej 36 muajve”.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës në ofertë ka prezantuar marrëveshjet ashtu siç ka kërkuar AK në njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit.

Marrëveshjet mbi qiranë të noterizuara si më poshtë:

1. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Drenas, Rruga Bejt Rexhepi me pronar Berlet Sejdiu
2. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Fushe Kosove, Rruga Fehmi Lladrovci (përball postes), me pronar Adem Karaxha,
3. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Graçanicë- Rruga Graçanice-Prishtine, me pronar Idriz Vrajolli,
4. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 13.01.2025, Podujeve, Rrugen Podujeve-Merdare, me

pronar Fatlum Behrami,

5. *Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Lipjan, Rruga Bajram Gashi 108, me pronar Burhan Jashari,*
6. *Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Obiliq, Rruga Hasan Prishtina 52, me pronar Qefser Morina,*
7. *Marrëveshja bashkëpunimi e datës 13.01.2025, Podujeve, Magj. Podujeve-Prishtine me pronar Ekrem Haliti,*
8. *Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Prishtine, Rruga Lidhja e Prizrenit nr.19, me pronar Rinor Brahimi,*
9. *Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Prishtine, Rruga Ahmet Krasniqi pn, me pronar Driton Dauti.*

Pretendimet tjera janë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kilometrat dhe nuk ka ofruar deklaratë të vulosur dhe nënshkruar për piken në Mutivode, se ku do të pastrohen automjetet e këtij kufiri.

Eksperti shqyrtues sqaron pretendimet ankimore të OE ankues, ku AK - Policia e Kosovës në dosje të tenderit nuk ka përcaktuar kilometrat për pikat te autolarjes dhe për pikën ne Mutivodë nuk ka kërkuar marrëveshje - deklaratë të vulosur, por ka sqaruar në FDT tek Aneksi 1. që pika në Mutivodë të pastrohen automjetet në pikën më të afërt, andaj, këto pretendime janë të pa bazuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK - Policia e Kosovës, ka respektuar dhe vepruar konform nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin ofertave duke u bazuar në depozitat ligjore të LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “GMM Group SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “SHËRBIMET PËR PASTRIMIN E AUTOMJETEVE POLICORE PËR REGJIONIN E PRISHTINËS” me numër të prokurimit: “214-24-13221-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **GMM Group SH.P.K.**

Burim Guri

